



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 16.11.2021

Lënda: Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Ngresi

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, referuar dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në seancat gjyqësore të datave 7.7.2021 dhe 26.7.2021, të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, vlerëson se:

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, është paraqitur jashtë afatit 15-ditor, të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se ky pretendim është i pabazuar në ligj¹. Ky qëndrim i Komisionerit Publik mbështetet dhe në jurisprudencën² e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjatë shqyrtimit të ankimeve të mëparshme të Komisionerit Publik.

2. *Për shkakun ankimor, deklaram i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për pasurinë “Apartament me sip. 144,8 m²”, subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në seancat gjyqësore në Kolegj, nuk paraqiti asnjë provë të re për të provuar të kundërtën. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbi mënyrën e deklaramit ndër vite të kursimeve në *cash*, për të cilat subjekti ka pasur detyrimin t’i deklaronte, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 5/1 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, nuk gjejnë mbështetje në prova. Referuar këtij parashikimi ligjor, nuk*

¹ Neni 44 i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikon se mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

² Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr. 32/2019, vendimit (JR) nr. 13/2021 dhe vendimit (JR) nr. 27/2021.

rezulton që subjekti të ketë deklaruar posedim të kursimeve *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës, të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 19.3.2010, duke mos provuar kështu mbulimin me burime të ligjshme të pagesës së shumës prej 20.000 euro, në vitin 2012, si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit në Vlorë.

2.1 Po kështu, edhe në vlerësimin e deklarimeve të subjektit mbi kursimet *cash*, të periudhës 2004-2007, Komisioneri Publik vlerëson se mbeti e paprovuar dhe mundësia financiare e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme kursimet në *cash*, të deklaruara në deklaratën e parë të pasurisë, për vitin 2004 (*trajtuar në shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e datës 7.7.2021*) dhe pretendimet e subjektit, për sa i përket këtyre kursimeve, nuk gjejnë mbështetje në prova.

2.2 Për sa i përket marrëdhënies me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe transaksioneve të kryera me këtë shoqëri, në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe pse deklarohet kthimi i shumës prej 17.000 euro nga kjo shoqëri³, mbetet i padokumentuar kthimi i kësaj shume dhe i paprovuar në vijim posedimi i saj si kursime në *cash*, nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar kthimin dhe posedimin e kursimeve *cash*, sipas detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 9049/2003 (të ndryshuar) të kësaj shume.

2.3 Komisioneri Publik, bazuar edhe në përmbajtjen e shkresës nr. ***/*** prot., datë ***.7.2021, të ILDKPKI-së, administruar nga Kolegji gjatë këtij gjykimi, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në kundërankimin e tij, datë 1.3.2021, dhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, janë të pabazuara.

2.4 Gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk provoi gjithashtu mbulimin me burime të ligjshme të kësteve të deklaruara të paguara në vitet 2014 dhe 2015 (sikundër trajtuar gjerësisht në ankim).

2.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, referuar nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 33, pika 5, germa “b”, 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë “*Apartament me sip. 144,8 m²*”.

3. *Për shkakun ankimor, deklaram i pamjaftueshëm i pasurisë Automjet tip “Skoda”, në vlerën 14.500 euro*, subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në seancat në Kolegj, nuk paraqiti provë të re për të provuar të kundërtën. Pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara. Në përfundim, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

4. *Për shkakun ankimor, deklaram i pamjaftueshëm i pasurisë Autoveturë “Fiat”, në vlerën 8.800 euro*, subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në seancat në Kolegj, nuk paraqiti provë të re për të provuar të kundërtën. Pretendimet e subjektit mbetën të paprovuara. Në përfundim për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

³ Referuar shkresës së shoqërisë “****” sh.p.k., “Kthim përgjigje kërkesës për informacion për Kolegjin e Posaçëm të Apelimt”.

5. Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

6. Kërkimi përfundimtar i ankimit

6.1 Në përfundim të këtyre bisedimeve përfundimtare, Komisioneri Publik, në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në dosje të Komisionit, provave dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor, të vendosur nga trupi gjykues, si dhe parashtrimeve dhe akteve/provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës, gjatë këtij hetimi gjyqësor, duke u qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të paraqitur prej tij, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, dhe nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, kërkon që shkaqet parashtruar në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Ngresi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA